



Relacion Teknik

Objekti: RIKONSTRUKSION I RRUGES BABUNJE - AGIM,
BASHKIA DIVJAKE



Fig.1 Horografia e zones



1. Te pergjithshme

Me parkun kombëtar Divjakë-Karavasta dhe fushat rurale pjellore, bashkia e re e Divjakës ofron një perspektivë të mirë zhvillimi për bujqësinë dhe ekoturizmin.



Fig.2 Qyteti i Divjakës

- **Kordinatat gjeografike te Divjakes**

Bashkia e re Divjakë kufizohet në veri me bashkinë Rrogozhinë, në lindje me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik. Kryeqendra e bashkisë së re do të jetë qyteti i Divjakës, i shpallur qytet me vendim qeverie në vitin 1996.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e Divjakës numëron një popullsi prej 34.254 banorësh ndërkohë që në regjistrin civil rezulton një popullsi 53.372 vetë. Territori i bashkisë së re është 309.58 kilometra katrore. Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 110 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti është 172.40 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradisht dhe Remas. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Lushnjes dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 36 fshatra. Për të parë listën e plotë të qyteteve dhe fshatrave të kësaj bashkie

- **Lartesia mbi nivelin e detit** varion nga 3m deri ne 5m. Largesia nga rruga lokale deri ne rrugen nazionale është rreth 16 km. Per tu ardhur ne ndihme banoreve qe te udhetojne ne vende te ndryshme ne Divjake ndodhet nje stacion autobuzash qe ploteson nevojat e qytetareve.Divjaka shtrihet ne brendësi te një fushe. Ne territorin e saj ka pasuri nëntokësore siç është gazi natyror. Këto pasuri janë shfrytëzuar nga njerëzit qe prej 30 vjetësh.
- **Klima** është mesdhetare dhe është një klime jo e shëndetshme sepse ka shume kontraste midis stineve.
 - Temperatura mesatare shumëvjeçare vjetore është 21 °C.
 - Temperatura mesatare shumëvjeçare e janarit është 5 °C.
 - Temperatura mesatare shumëvjeçare e korrikut është 30 °C.
 - Temperatura minimale absolute është -1 °C.



- Temperatura maksimale absolute është + 38 °C.
- **Reshjet** bien kryesisht ne stinën e pranverës. Reshjet e dëborës janë te rralla ne këtë vend. Reshjet e breshërit bien me shume ne stinën e pranverës. Takohen deri ne 3 dite me breshër ne vit. Ngricat janë te rralla. Takohen deri 10 dite me ngrica ne vit. Ngricat e para shfaqen ne muajin janar ndërsa te fundit ne muajin mars. Periudha e thatësirës zgjat rreth 90 dite ne vit. Ka pasur raste edhe te thatesirave te tejzgjatura dhe kane qene rreth 3 raste ne 10 vjet.
- **Era** është e shpeshtë. Erërat dominuese te gjysmës se ngrohte te vitit vijnë nga jugu ndërsa te gjysjmes se ftohte nga veriu. Ne Divjakë nuk mungon edhe rasti i stuhive. Ato ndodhin me shpesh ne mars dhe numërohen mesatarisht 2 dite me stuhi ne vit. Demet qe kane sjelle stuhite kane qene : rrëzimi i drithërave, rrëzimi i pemëve te vjetra qe shpesh here shkaktonte edhe rrëzimin e linjave elektrike.

Mendohet se kodrat e Divjakes deri ne afersi te Terbufit kane qene te banuara qysh ne kohet e lashta. Kjo vertetohet edhe nga shume objekte arkeologjike te gjetura ne keto kodra, si nga varret e shumta qe gjenden neper keto vende. Ne jug te Divjakes ne afersi te fshatit Mize dhe Xeng nga hapja e nje kanali kullues u gjenden disa tjegula , copa rrexylly, nje gozhde kovaei 12 cm, dhe dy rrota me diameter 18 & 10 cm dhe fragmentesh enesh te ndryshme. Copat e tjegulave dhe te tullave te gjetura ne kete are jane idetike me tjegullat e tullat e gjetura neper varret e fshatrave te permendur me siper. Ne fshatin Mize jane gjetur rreth e rrotull varre te mbuluar me tjegulla me permas 70×40×2cm, poee e pjata balte si dhe vegla pune hekuri, te cilat i perkasin mesjetes se hereshme.

Te gjitha materialet te cilet jane gjetur si: Hanxhare, heshtat, pjatat kandilat, kane pas egzistuar ne muzeun e Divjakes dhe i perkisnin shekullit III-II para eres sone. Me perjashtim te pak eneve helenistike e te ndonje objekti tjeter, te gjitha te tjerat jane lliro-shqiptare. Si do qe te jete fakt është se Divjaka dhe kodrat perreth saj kane qene te banuara qe ne kohe te lashta nga fisi i njohur Ilir i Taulanteve dhe me vone nga shqiptaret e hershem.

Nje fakt tjeter është nje gure i gjetur ne Divjake me mbishkrim latin i cili është nje gure rruge dhe deshmon se ne kete zone ka pasur kaluar nje rruge qe lidhte Apollonin me Dyrrahun (Durrësin) dhe thuhet se ka qene nje dege e rruges Egnatia qe shkonte per ne Skampa (Elbasan) sipas hartes Krahina jone ne shekujt IV-V te eres sone



Fig.3 Bashkia Divjakë

- **Profili i bashkisë**

Bashkia e Divjakës është nga të paktat bashki të krijuara nga reforma administrative dhe territoriale e cila përbëhet pothuajse tërësisht nga zona rurale. Bashkia e re ka një shtrirje veri-jug ndërkohë që rrugët janë më së shumti në drejtimin lindje-perëndim dhe lidhja rrugore mes qytetit të Divjakës dhe komunave Gradishtë e Rremas është e dobët.

Bashkia e re ndodhet në një zonë tërësisht rurale dhe pjellore, ndërkohë që pjesë e territorit të kësaj bashkie është edhe parku kombëtar Divjakë-Karavasta, si dhe plazhi i Divjakës.

Bashkia e re ka aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe në një masë më të vogël peshkimin në lagunën e Karavastasë. Prodhimi kryesor bujqësor janë bostanoret, të cilat shiten në tregun e brendshëm si dhe eksportohen në shumë vende të Europës qendrore dhe lindore.

Divjaka ka perspektivë të mirë për zhvillimin e turizmit detar si dhe ekoturizmit. Gjatë viteve të fundit këtu është shfaqur turizmi i vrojtimit të zogjve për shkak të pranisë së një kolonie të vogël pelikanësh në zhdukje në lagunën e Karavastasë.

Turizmi është zhvilluar më së shumti për turistët ditorë dhe kulinaria është e përqendruar te prodhimet e peshkut, për të cilat zona është e famshme në të gjithë vendin.

Territori i Bashkisë zë afro 1% të sipërfaqes të tërë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Bashkia e DIVJAKËS në veri kufizohet me lumin Shkumbin, në lindje me Bashkinë Lushnjë dhe autostraden SH 4, në jug me Bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik. Në përgjithësi relievi i Bashkisë Divjakë është fushor dhe i butë kodrinor.

Divjaka si Bashki ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike. Territori i Bashkisë Divjakë gjendet në pjesën Perendimore të Shqipërisë. Bashkia shtrihet në drejtimin veri-jug me gjatësi maksimale të vijes bregdetare prej rreth 30 km dhe lindje-perëndim me një gjatësi maksimale prej 20 km.

2. Gjendja aktuale e Ndërtimit



Fig.4 Pamja ekzistuese e rruges Babunje - Agim

Rruga Babunje - Agim ndodhet ne jug-lindje te qytetit te Divjakes. Ajo eshte pjese e rruges lidhese me bashkine e Fier-it , gjithashtu do te beje te mundur lidhjen e kesaj zone me Bashkine e Fier-it



ne fshatin Agim, pjesa qe mbulohet nga Bashkia Fier është e sistemuar dhe asfaltuar dhe sistemimi i këtij segmenti rrugor do te bënte te mundur lidhjen e dy Bashkive nëpërmjet këtyre rrugëve bujqësore e cila do ti jepte shume zhvillim zonës përreth. Ne segmentin Babunje - Agim nuk është ndërhyre ne mënyre te thelle nga njësia administrative, rruga Babunje - Agim është e trajtuar me çakëll, ajo është shume te ngushta jashtë çdo norme apo standarti. Ky segment do te shkurtonte shume transportin e njerëzve dhe prodhimeve bujqësore për zonat e Lushnjës, Beratit, Fierit dhe Kuçovës etj. Gjendja ekzistuese e kësaj rruge nuk është ne gjendje te mire dhe për me tepër është shume e ngushte duke beret e mundur vetëm kalimin e mjeteve te vogla. Kjo rruge ne një pjese është menduar si zone urbane ku është dhe fundi i këtij segmenti. Ne ketë segment shtresat janë zhdukur fare si rezultat I degradimit te tyre. Ujerrat e shiut janë te pa sistemuar duke krijuar pellgje te mëdhenjtë me ujera ne kohe shiu.

Pjesa e pare Fshati Babunje është e ngushte si rruge duke mos lejuar shkëmbimin e dy makinave te vogla. Asfalti i këtij segmenti me penetrim ne disa seksione është i prishur si rezultat i mos kanalizimit te ujerave te shiut dhe mungesa e veprave te artit.

3. Ndërhyrjet qe do te bëhen ne Objekt

Projekti parashikon një sistemim te plote, asfaltim dhe rikonstrukcion te segmentit Babunje - Agim.

Në objekt parashikohet te realizohen punimet e gërmimit dhe të mbushjes, në një gjatësi prej 4.5 kilometrash.

Do ndërhyhet ne asfaltin ekzistues dhe do te realizohet rruga e re me paketën e shtresave te parashikuar nga projektuesi.

Përfundimi i rikonstrukcionit te këtij segmenti rrugor do të lehtësojë ndjeshëm lëvizjen e banorëve të zonës drejt bashkisë së Divjakës sipas ndarjes së re territoriale, gjithashtu do ti japë një impakt të ri tregtimit të produkteve të këtyre fshatrave në tregun e Divjakës, i cili është tregu më i afërt për ta.

Kjo zonë bujqësore do të dalë më në pah me rrugën e re, e cila në të njëjtën kohë do ti japë një shtysë të re edhe turizmit.


Është zonë e pastër, nuk ka ndërtime dhe nuk janë bere ndonjëherë ndërhyrje ne infrastrukturën e kësaj zone.


Realizimi i këtij projekti ka rendësi te veçante sepse jo vetëm qe lidh banoret e këtij komuniteti me Bashkinë e madhe por nga anën tjetër i jep gjithë pjesës së fshatit Agim një rrugë te shfrytëzueshme qe shkurton kohe dhe siguron shpejtësi ne lëvizje. Rruga Babunje - Agim është

Karakteristikat kryesore të rrugës së këtij segmenti janë parashikuar në përputhje të plote me terrenin pa prishur dhe pa bërë ndërhyrje të papërshtatshme duke ndikuar negativisht në peisazhin e vendit.

Sipas verifikimeve që janë bërë nga grupi i projektimit dhe nga grupi i punës së bashkisë Divjake, ka rezultuar që përgjatë kësaj rruge nuk do të kemi shpronësime.

- **Progresiva 0+000 ÷ 0+300**





Karakteristikat kryesore te këtij segmenti janë:

- Dy korsi lëvizëse me gjerësi përkatëse 2.75 m
- Trotuar ne një ane me gjerësi 2 m
- Kuneta betoni ne te dy anët gjerësi 50cm
- Ndarjet përkatëse te këtyre elementeve shoqërohen me bordura me dimensione 20x35 cm.

Gjate këtij segmenti është menduar qe gjelbërimi te realizohet me peme dekorative te përshtatshme për këtë zone te gjelbëruar e te mbrojtur si park natyror.

Një element shume i rëndësishme i këtij segmenti është realizimi i ndriçimit përgjatë gjithë rrugës, dhe kjo është menduar te zgjidhet me ndriçues me lartësi te ndryshme me një llambe me fuqi 150w, e përshtatshme për te bere ndriçimin e korsise lëvizëse dhe trotuarit.

Paketa e shtresave te rrugës e parashikuar nga projektuesi përmban këto elemente kryesore:

- Asfalt 3 cm
- Shtrese Bideri 6cm
- Shtrese stabilizanti 10cm
- Mbushje me cakell 0 – 100 dhe ngjeshje deri 95% Proktor 1x20cm dhe 1x25cm
- Dhe i ngjeshur

Shtresat e trotuarit janë parashikuar si me poshtë:


- Shtrese me pllaka betoni
- Shtrese betonarme 10cm
- Mbushje me cakell 0 – 100 dhe ngjeshje deri 95% Proktor 20cm

- *Shtresa ekzistuese*

• **Progresiva 0+300.00 – 0+618.000**


PROFIL TIP NR. 3

PROG. 0+300 ÷ 0+440



PROFIL TIP NR. 4

PROG. 0+300 ÷ 0+440



• **Progresiva 0+700 ÷ 2+150**

Ne këtë zone është menduar të realizohet rrugë me gjerësi 6.5 m.




Fig.10 Profil tip

Karakteristikat kryesore të këtij segmenti janë:

- Dy korsi lëvizëse me gjerësi përkatëse 2.75m
- Bankina të pa asfaltuara 2 x 0.5 m


Gjatë këtij segmenti është menduar që gjelbërimi të realizohet me peme dekorative të përshtatshme për këtë zonë të gjelbëruar e të mbrojtur si park natyror e cila mund të bëhet nga Bashkia në një fazë të dytë.

Përgjatë rrugës janë parashikuar të zgjerohen 4 tombino me hapësirë drite që variojnë nga Hd = 3m (prog 0+240), Hd = 2x4m (prog 672) , Hd=1m (prog 0+352) dhe Hd = 4m ((2+140). Zgjerimi i këtyre tombinove është dhënë në projekte tip të dhëna në projekt. Zgjerimi përfshin zgjatimin e ballinave majtas dhe djathtas aksit si dhe zgjerimin e soletës.

Gjithashtu janë parashikuar intersektime të tjera të dëmtuara me tombino Ø600mm.

• **Progresiva 2+150 ÷ 4+450**

Ne këtë zone është menduar te realizohet rruge me gjerësi 6.5 m.



Karakteristikat kryesore te këtij segmenti janë:

- Dy korsi lëvizëse me gjerësi përkatëse 2.75m
- Bankina te pa asfaltuara 2 x 0.5 m
- *Asfalt 3 cm*
- *Shtrese Binderi 6cm*
- *Shtrese stabilizanti 10cm*
- *Mbushje me cakell 0 - 100 dhe ngjeshje deri 95% Proktor 1x20cm dhe 1x25cm.*
- *Dhe i ngjeshur*

Gjate këtij segmenti është menduar qe gjelbërimi te realizohet me peme dekorative te përshtatshme për këtë zone te gjelbëruar e te mbrojtur si park natyror e cila mund te behet nga Bashkia ne një faze te dyte.




Fig 11. Zgjerimi i tombinove

Një nga detyrat kryesore te projektuesit ne realizimin e këtij segmenti rrugor është qe rruga te ketë funksionin e saj te sigurimit te shpejtësisë se lëvizjes brenda normave te përcaktuara ne manualet rrugore e shoqëruar me sinjalistikën vertikale dhe atë horizontale, e nevojshme për shmangien e rreziqeve te aksidenteve rrugore te komunitetit ku do te realizohet kjo vepër inxhinierike.




Fig.14 Sinjalistika rrugore




Fig.15 Sinjalistika rrugore

Për të gjithë materialet ndërtimore të zgjedhura nga projektuesi për segmentin rrugor do të kryhen provat dhe testet e nevojshme që japin garancinë e cilësisë dhe që ofrojnë lëvizjen e automjeteve dhe këmbësoreve në mënyrë të sigurt.

Për “C.E.C GROUP” sh.p.k

Ing. Vangjush MBRIÇE

Ing. Anduen MBRIÇE